



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete e Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur më datë: **07.11.2025**, me fillim në orën **09:40**. Këtë mbledhje e kryesoi si zakonisht kryesuesi i Komitetit për Komunitete, **z. Bajram Morina**.

Kryesuesi: Fillimisht, përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për kontributin dhe praninë tuaj. Përshëndetje për zëvendëskryesuesin Dusan Stojanovic, për përfaqësuesit e KFOR-it, OSBE-së, anëtarët e Komitetit për Komunitete dhe të gjithë të pranishmit. Ky është takimi i **pestë** dhe me gjasë i fundit për vitin 2025. Për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë nga Drejtorja e Shërbimeve Publike rreth infrastrukturës në lagjet ku jetojnë komunitetet joshumicë;**
- 3. Të ndryshme.**

Kryesuesi: Atëherë, ky është rendi i ditës për sot. Nëse dikush nuk ka diçka për të thënë, si të tillë po e vendosim! Kush është “për”?... Me shumicë unanime aprovohet rendi i ditës.

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: A ka dikush ndonjë gjë rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar? Nëse jo, atëherë e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Konstatoj që unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Informatë nga Drejtorja e Shërbimeve Publike rreth infrastrukturës në lagjet ku jetojnë komunitetet joshumicë:

Përparim Krasniqi: Faleminderit kryesues! Përshëndetje për anëtarët e Komitetit për Komunitete, monitorues nga LMT-ja, OSBE-ja. Ne kemi një bashkëpunim të ngushtë me Zyrën Komunale për Komunitete dhe të gjitha kërkesat që adresohen shkojnë paralelisht me investimet në çdo lokalitet ku jetojnë komunitetet joshumicë. Një mori investimesh kanë ndodhur në lagjen e epërme të qytetit: ndërhyrje në infrastrukturë rrugore, ndriçim publik, kanalizim. Në Krushë të Madhe ka pasur ndërhyrje në mur mbrojtës, në rrethim të varrezave dhe në kubëzim të rrugëve. Në Ratkoc gjithashtu ka pasur ndërhyrje në kanalizim dhe në ndërtim të rrugëve lokale. Për të gjitha kërkesat e adresuara, jemi këtu për t'i zgjidhur.

3. Të ndryshme:

Ramë Berisha: Ju përshëndes të gjithëve! Gjatë këtij viti kemi bërë disa takime, në lidhje me pikat e caktuara. Ne anëtarët, kemi qenë aktivë me raportime rreth rasteve të ndryshme. Ndoshta ndonjëherë e kemi bërë ndonjë gabim, por asnjëherë me qëllim. Vazhdojmë të kontribuojmë për komunitetin me kërkesa të ndryshme, të cilat realizohen nga ekzekutivi. Ju përshëndes!

Faton Ramadani: I nderuar kryesues, anëtarë të komitetit, ju monitorues. Ju falënderoj për angazhimin dhe kontributin tuaj gjatë këtij rrugëtimi 4-vjeçar. Puna jonë e përbashkët në kuadër të komitetit, ka qenë shembull i bashkëjetesës, mirëkuptimit dhe përkushtimit. Uroj që kemi bërë punë të mira. Për 4-vjeçarin e

ardhshëm shpresoj që ekzekutivi të jetë më aktiv këtu në këtë komitet, sepse ky komitet mund të bëjë edhe më shumë shërbim në kuadër të komuniteteve.

Merisa Sharku: Përshëndetje për të gjithë! E kam një vërejtje, sepse jo rrallëherë kanë munguar përfaqësuesit nga ekzekutivi që kanë pasur pika për raportim në mbledhjen e Komitetit për Komunitete. Në mandatin tjetër kjo gjendje nuk duhet të përsëritet, sepse çdo kush duhet ta dijë përgjegjësinë që i takon. Çdo komitet obligativ e ka rëndësinë e vet. Sa i përket gjendjes në infrastrukturë që raportoi drejtori: situata nuk është bash në gjendjen të cilën e proklamojë ai, sepse për këtë arsye foli në pika të përgjithësuara. Në vendbanime ku jetojnë komunitetet joshumicë, duhet të ketë më shumë intervenime dhe më shumë punë. Ju falënderoj të gjithëve për bashkëpunimin dhe për kontributin sado të vogël që e kemi dhënë këtu.

Përparim Krasniqi: Merisë, e përmende fjalën “neglizhencë”, por nuk është e vërtetë që ka ndodhur një gjë e tillë. Unë jam i vetëdijshëm për secilën punë që është kryer në vendbanimet ku jetojnë komunitetet joshumicë. Konkretisht është mirë të tregoni se ku ka nevojë të intervenojmë dhe ne të marrim masa për punë, sepse nuk mund të jemi në dijeni ndoshta për secilin problem që shfaqet. Në lagjen e epërme ka investime të mëdha në infrastrukturë dhe së fundi është intervenuar në rregullimin e energjisë elektrike, si dhe të njëjtën kohë jemi duke e trajtuar edhe ndriçimin publik.

Merisa Sharku: Pothuajse të gjitha problematikat përmendjen këtu në mbledhje e më pas ju intervenoni. Problematika e kanalizimit gjithashtu është përmendur këtu fillimit.

Kryesuesi: Nëse nuk ka dikush ndonjë gjë tjetër, po e mbyllim takimin e sotëm. Ju falënderoj të gjithëve për kontributin tuaj!

Mbledhja përfundoi: 10:10

Procesmbajtësi

Kryesuesi i mbledhjes

Albion Krasniqi

Bajram Morina